

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“GLOBAL CHANGE” SHPK**

Sot më Datë 18.11.2022, themelohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “GLOBAL CHANGE”, sipas parashikimeve të këtij Akt Themelimi.

**NENI 1  
Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.1 Themelohet Shoqëria “Global Change”.
- 1.2 Shoqëria organizohet në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

**NENI 2  
Themeluesit**

- 2.1 Ortak Themelues i Shoqërisë “Global Change” Shpk është Alban Papushi, Shtetas Shqiptar, lindur më 28.02.1991 në Pukë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr.036170036 dhe Nr.Personal J10228062H.

**NENI 3  
Selia e Shoqërisë**

- 3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, Rruga “Bulevardi Zogu i Parë”, Shkalla 0, përballë me “Tirana Bank”, Zona Kadastrale 8360, Nr.Pasurie 6/133-N1, Tiranë.
- 3.2 Shoqëria, në kuadër të ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar, ka të drejtë të hapi adresa sekondare në të gjithë territorin e vendit.

**NENI 4  
Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

- 4.1 Shoqëria do të ushtroj veprimtarinë e saj për një afat kohor të pakufizuar.

**NENI 5  
Objekti i Veprimtarisë**

- 5.1 Shoqëria do të operojë në fushat e mëposhtme:
  - a) Në fushën e veprimtarisë financiare të këmbimeve valutore;
  - b) Në fushën e agentit Union Net-Western Union, për transferimin e parave.
  - c) Në fushën e shërbimit të pagesave utilitare;

**NENI 6  
Kapitali**

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë.
- 6.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga një kuotë e vetme, e cila zotërohet nga Ortaku Themelues i saj, Z.Alban Papushi.



6.3 Vlera e kontributit të Ortakut Themelues për nënshkrimin e Kapitalit të Regjistruar, është në para dhe është shlyer nga Ortaku tërësisht, përpara regjistrimit të Shoqërisë.

#### **NENI 7** **Organet e Shoqërisë**

- 7.1 Organet e Shoqërisë janë:
- a) Asambleja e Përgjithshme;
  - b) Administratori;

#### **NENI 8** **Asambleja e Përgjithshme**

8.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë dhe përbëhet nga Ortaku themelues i saj apo Ortakët që mund të hyjnë më vonë në Shoqëri, përmes pjesëmarrjes në Kapitalin e Regjistruar të saj.

8.2 Cdo Ortak ka të drejtë të marri pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

8.3 Cdo Ortak në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

#### **NENI 9** **Emërimi dhe Kompetencat e Administratorit**

9.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë individ në pozitën e Administratorit të Shoqërisë. Administratori mund të zgjidhet nga rradhët e Ortakëve të Shoqërisë ose jashtë saj.

9.2 Afati i emërimit të Administratorit nuk mund të jetë më i gjatë se pesë vjet, me të drejtë rizgjedhje.

9.3 Administratori i Shoqërisë "Global Change" Shpk, emërohet Z.Alban Papushi, për një afat 5 vjecar, me të drejtë rizgjedhje. Afati 5 vjecar fillon nga Data 18.11.2022 deri me Datë 18.11.2027.

#### **NENI 10** **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

10.1 Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij Akti Themelimi, kompetente do të jetë Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

10.2 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe Ortakëve të saj, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



**ORTAKU THEMELUES  
ALBAN PAPUSHI**

*Alban Papushi*  


*Ky Akt Themelimi përbëhet nga 3 faqe dhe nënshkruhet në dy kopje origjinale me vlerë të njëjtë, në Tiranë, sot më Datë 18.11.2022*